



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:277283

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06181010

KPPP.nr. 534/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbaremore të kreditorit “Solvit” Sh.P.K., me numër të biznesit 70889676 dhe seli në Prishtinë, rr.”Ilaz Kodra” – QT Kroj i Bardhë, kundër debitorit “Trepça” Sh.A., me numër unik identifikues 811278747 dhe seli në Mitrovicë, Parku Industrial, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr. 232/20, të datës 09.10.2020, të lejuar nga Përmbareuesi Privat Myjsere Mujku nga Prishtina, jashtë seancës me datën 19.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Trepça” Sh.A., ashtu që Urdhri Përmbaremore P.nr. 232/20 i datës 09.10.2020, i lejuar nga Përmbareuesi Privat Myjsere Mujku, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbareuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Solvit” Sh.P.K., me datë 09.10.2020 ka lëshuar urdhrin P.nr. 232/20, duke lejuar përmbareimin në bazë të dokumentit: Faturë nr. 20453 e datës 11.08.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “Trepça” Sh.A., që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 8,910.00 EUR (tetëmijë e nëntëqind e dhjetë euro) me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore aq sa do të krijohen deri në pagesën definitive të borxhit.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbaremore, me arsyetimin se dokumentet në bazë të cilave është marr vendimi përmbareues ose urdhri përmbareues nuk janë të përshtatshme për përmbareim sepse nuk është cekur koha e

përmbushjes së detyrimit, ashtu siç parashihet me nenin 27, par. 1 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të anulojë urdhrin për përmbarim P.nr. 232/20, të datës 09.10.2020.

Kreditori në përgjigjen në prapësim ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetimin se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor përmban datën e lëshimit të faturës si dhe datën e skadimit të pagesës sipas kësaj fature. Andaj, pretendimet e debitorit në prapësim kanë si qëllim zvarritjen e procedurës duke pamundësuar përmbushjen e detyrimit ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 20453 e datës 11.08.2020, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi, e po ashtu fatura i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së.

Tutje, Gjykata gjeti se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit si në faturë, ndërsa fakti që debitori ka qenë në dijeni për detyrimin sipas kësaj fature, vërtetohet edhe nga kontrata nr. 20 059 136 e datës 28.07.2020

e lidhur mes palëve ndërgjyqëse, ku lënda e kontratës dhe çmimi i saj është i njëjtë me objektin e detyrimit dhe lartësinë e faturës objekt i këtij përmbarimi.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit se në faturën në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarimor nuk është cekur koha e përmbushjes së detyrimit, mirëpo gjeti se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë për faktin se në të njëjtën është cekur afati i pagesës, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 534/24, datë 19.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.